



VENDIM

Nr.10 Datë 08.02.2010

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“POWER ELEKTRIK SLABINJE” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.02.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “POWER ELEKTRIK SLABINJE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “POWER ELEKTRIK SLABINJE” shpk në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. “POWER ELEKTRIK SLABINJE” shpk të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.
3. Afati i vlefshmerisë së liçensës të jete 30 vjet.
4. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryeatri i ERE-s

Bujar Nepravishta